

VENDIM
Nr. 102/2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 94/2017,
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË”

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerëve Publikë”, e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerëve Publikë”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Komisionerëve Publikë”, e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, “Struktura organizative e Komisionerëve Publikë”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.10.2018

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KOMISIONERI PUBLIK		(4)
Komisionerë Publikë	G3*	2
Sekretarë	Sekretar në kabinetin e ministrit**	2
II. KANCELAR	I-a	(1)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(10)
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	6
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	4
IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(7)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie	III-b	2
Specialist redaktor gjuhësor	IV-a	1
Përkthyes	II-b	1
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	IV-a	1
V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(8)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT***	III-b	1
Specialist protokoll/arkivi****	IV-a	1
Magaziniere	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer/korrier	VI	1
TOTAL		30

Shënim.

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për pozicionin e sekretarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfutojnë shtesën për natyrë të veçantë pune, në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi përfutojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMISIONERËVE PUBLIKË

